



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 8.1.2025

Nr: 10

Ora: 13:00

VENDIM

PËR

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË TIRANË, ME
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E “PARTISË SOCIALISTE TË
SHQIPËRISË”, Z. SEAD LATIF KAZANXHIU**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 42637/1 prot., datë 20.11.2024, Këshilli i Bashkisë Tiranë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, z. Besart Ilirian Kadia, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë.

Referuar nenit 164, pika 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, për Këshillin e Bashkisë Tiranë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 38, z. Sead Latif Kazanxhiu.

Me shkresën nr. 3368, prot., datë 27.11.2024, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Tiranë, z. Sead Latif Kazanxhiu, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të

Data: 8.1.2025 Nr: 10
Ora: 13:00



“Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Tiranë me kandidatin nga lista shumemërore e “Partisë Socialiste të Shqipërisë”, z. Sead Latif Kazanxhiu”

dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër TR-PS-3892_1_1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të z. Sead Latif Kazanxhiu, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit me shkresën nr. 3495 prot., datë 10.12.2024, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe me shkresën nr. 3494 prot., datë 10.12.2024, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore për z. Sead Latif Kazanxhiu.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 13125/1 prot., datë 19.12.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar z. Sead Latif Kazanxhiu, ku konstatohet se kandidati nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr.19259/1 prot., datë 18.12.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për z. Sead Latif Kazanxhiu, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar z. Sead Latif Kazanxhiu, në Këshillin e Bashkisë Tiranë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreun V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike

V E N D O S:

1. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Tiranë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, z. Sead Latif Kazanxhiu.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Iirjan CELIBASHI